VENDIM
Nr. 268, datë 10.12.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "VOLTON" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", si dhe 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2293/9 prot., datë 3.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Volton' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Volton" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2293 prot., datë 28.10.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 235, datë 5.11.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 6.11.2024 dhe 7.11.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 15.11.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- ERE, me shkresën nr. 2293/3 prot., datë 19.11.2024, ka njoftuar shoqërinë për vendimin e sipërcituar dhe i ka kërkuar të plotësojë informacionin/dokumentacionin e konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht prej saj.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2293/6 prot., datë 26.11.2024 dhe nr. 2293/8 prot., datë 3.12.2024, shoqëria ka plotësuar informacionin/dokumentacionin e munguar për këtë aplikim.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Volton" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Volton" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti